



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT**

**QEVERIA E KOSOVËS/ MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
VLADA KOSOVA/ MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
GOVERNMENT OF KOSOVA/MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT**

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural duke u bazuar në Rregulloren e UMNK-ut nr. 2001 / 19 të datës 13 shtatorë 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, neni 1.3 pika (d), nenit 7, nenit 8 dhe neni 5 të Ligjit për Blegtorinë e Kosovës Nr. 2004/33 të datës 8 shtator 2004 nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV MA-Nr. 04/2005

**Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës për Mbarëshkrimin e Kafshëve,
certifikimin e personave dhe Organizatave që ndërmarrin aktivitete në
mbarëshkrimin e kafshëve**

Kapitulli I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Udhëzim Administrativ rregullohet organizimi dhe funksionimi i Qendrës për mbarëshkrimin e kafshëve shtëpiake (në vazhdim: QMK), udhëheqja me Qendrën, detyrat e Qendrës, certifikimi i personave dhe Organizatave që ndërmarrin aktivitete në mbarëshkrimin e kafshëve shtëpiake, Regjistri i Shoqatave për mbarëshkrimin e kafshëve shtëpiake, udhëheqja e Librave mëzorë, licencimi i personave për mbarsim si dhe aprovimi i importeve të materialit riprodhues.

Organizimi dhe funksionimi i Qendrës për Mbarëshkrimin e Kafshëve

Neni 2

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (në vazhdim:MBPZHR) është themeluese e Qendrës për Mbarëshkrimin e Kafshëve.

Neni 3

Qendra për Mbarështimin e Kafshëve do të financohet dhe do të punojë nën autoritetin e Departamentit të Prodhimtarisë Blegtorale (në vazhdim: DPB) në MBPZHR.

Detyrat e Qendrës për Mbarështimin e Kafshëve

Neni 4

Detyrat e përhershme të Qendrës për Mbarështimin e Kafshëve do të përfshinë grumbullimin e të dhënave, vlerësimin dhe analizimin e raporteve për nevoja të Ministrisë dhe mbarështuesve që kanë të bëjnë me çështjet e mbarështimit për të gjitha llojet, racat dhe hibridet e kafshëve shtëpiake.

Deri në autorizimin e Shoqatave të mbarështuesve të kafshëve, Organizatave të mbarështuesve ose Ndërmarrjeve private Qendra për Mbarështimin e Kafshëve do të kryej këto funksione:

- a. regjistrimet e nevojshme të mbarështimit për mbajtjen e Librave amëz në pajtim me kriteret e dhëna në Udhëzime Administrative për mbarështimin e kafshëve;
- b. zbatimin e rregullave dhe metodave për regjistrimin e performances, përcaktimin e vlerës gjenetike dhe publikimin e rezultateve të vlerësimit të mbarështimit të llojeve, racave të kafshëve dhe kafshëve hibride.
- c. testimin laboratorik të materialit gjenetik.
- d. hartimin e Programeve zhvillimore në mbarështimin e kafshëve.
- e. përpilimin dhe lëshimin e Certifikatave të mbarështimit.
- f. i u propozon Organizatave të mbarështuesve dhe/ ose Ndërmarrjeve private racat dhe hibridet për listën preferenciale të kafshëve dhe hibrideve si dhe propozon ndryshimet në listë

Udhëheqja e Qendrës për Mbarështimin e Kafshëve

Neni 5

Qendra për Mbarështimin e Kafshëve monitorohet dhe këshillohet nga Bordi.

Neni 6

Bordi përbëhet prej 5 (pesë) anëtare:

- a. Përfaqësuesi i Ministrisë 1 (një) vend
- b. Organizatat mbarështuese dhe /ose Ndërmarrjet private të autorizuara për themelimin dhe mbajtjen e Librave mëzorë 2 (dy) vende
- c. Personat e licencuar për kryerjen e mbarësimit artificial 1(një) vend

d. Përfaqësuesi i Fakultetit të Bujqësisë 1 (një) vend.

Bordi e cakton kryetarin e Bordit.

Anëtarët e Bordit zgjidhen me mandate prej 2 viteve.

Neni 7

Detyrat e Bordit janë:

- Këshillon Udhëheqësin e Qendrës dhe Departamentit të Prodhimtarisë Blegtorale për çështje që kanë të bëjnë me udhëheqjen e Qendrës për mbarështimin e kafshëve;
- Propozon Programin e punës të Qendrës për mbarështimin e kafshëve;
- Shqyrton Planet e punës të përgatitur nga kryetari;
- Shqyrton Raportet periodike dhe përfundimtare të Qendrës për Mbarështimin e Kafshëve;
- Çështjet tjera të natyrës këshillëdhënëse për zhvillimin e Qendrës për Mbarështimin e Kafshëve.

Neni 8

Bordi do të takohet çdo 6 muaj e në rast nevojë Bordi mund të mbajë mbledhje të jashtëzakonshme me propozimin e shumicës së anëtare të Bordit.

Neni 9

Qendra për Mbarështimin e Kafshëve udhëhiqet nga Udhëheqësi i Qendrës për Mbarështimin e Kafshëve i cili zgjidhet nga Ministria.

Detyrat e udhëheqësit të Qendrës për Mbarështimin e Kafshëve janë:

- Nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Drejtorit të Departamentit të Prodhimtarisë Blegtorale është përgjegjës për menaxhimin dhe koordinimin e përgjithshëm të Programit të punës së Qendrës për Mbarështimin e Kafshëve;
- Harton programe për përmirësimin racorë, promovon raca të pastërta, përmes Organizatave mbarështuese dhe bën distribuimin e informatave të racës.
- Binjakëzimi me Organizatat ndërkombëtare të mbarështimit si dhe bashkëpunimi me Institucionet hulumtuese në fushën e mbarështimit të kafshëve dhe ruajtjen e resurseve gjenetike;
- Mbështetë krijimin dhe aktivitetet e Shoqatave të mbarështuesve;
- Organizon dhe mbikëqyrë mirëmbajtjen e regjistrave, Librave amësorë dhe për të njëjtat është përgjegjës;
- Publikon të arriturat në lëmin e mbarështimit;
- Merr pjesë në takimet e Bordit, pa të drejtë vote.

Neni 10

Organizimi i brendshëm, përcaktimi i vendeve të punës, përshkrimi i punëve dhe detyrave punuese për çdo vend të punës veç e veç, numri i ekzekutuesve në çdo vend pune në Qendrën për Mbarëstimin e Kafshëve do të përcaktohen me Udhëzimin Administrativ për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Kapitulli II

Çertifikimi i Shoqatave të Mbarështuesve

Neni 11

Çdo Shoqatë e mbarështuesve të kafshëve, Organizatë dhe/ose Ndërmarrje private mbarështimi duhet të bëjë kërkesë në Departamentin e Prodhimtarisë Blegtorale të MBPZHR-së për t'u certifikuar për mbajtjen ose themelimin e Librave amësor ose Regjistrave të kafshëve.

Departamenti i Prodhimtarisë Blegtorale i MBPZHR certifikon çdo Shoqatë të mbarështuesve, Organizatë dhe /ose Ndërmarrje private mbarështuese e cila mbanë ose themelon Libra amësorë dhe Regjistra të kafshëve nëse i plotësojnë kushtet e përcaktuara sipas këtij Udhëzimi Administrativ.

Kushtet për certifikim

Neni 12

Kërkesat e përgjithshme për certifikimin e Shoqatave të mbarështuesve, Organizatave dhe /ose Ndërmarrjeve private të cilat mbajnë ose themelojnë Libra amësor, Regjistra dhe Regjistra të hibrideve.

Me qëllim të njohjes zyrtare të një shoqate të mbarështuesve, Organizatave dhe/ose Ndërmarrjeve private e cila mbanë ose themelon Libra amësorë, Regjistra dhe regjistra të hibrideve duhet:

- 1) të ketë cilësinë e personit juridik;
- 2) të dëshmoi tek autoritetet kompetente:
 - a. se punon me efikasitet,
 - b. të prezenti Programin për përmirësim racorë,
 - c. se mundet t'i kryejë kontrollet e duhura për regjistrim të pedigreeve,
 - d. se madhësia e kopesë është e mjaftueshme për të zbatuar programet e përmirësimit racorë ose madhësia e kopesë është e mjaftueshme për t'a ruajtur racën aty ku konsiderohet e nevojshme,
 - e. se mund të shfrytëzoi të dhënat mbi performancën e kafshëve të domosdoshme për programet për përmirësim ose ruajtje të racës

Shoqata e mbarështuesve, Organizata dhe/ose Ndërmarrja private do të aplikoi rregulla me të cilat mbulojnë:

- a. përcaktimin e karakteristikave racore,

- b. sistemin e identifikimit të kafshëve,
- c. sistemin për regjistrimin e pedigreve,
- d. përcaktimin e qëllimeve të mbarështimit,
- e. sistemin për shfrytëzimin e të dhënave mbi performancën e kafshëve.

Refuzimi i certifikimit

Neni 13

Në rastet kur për një racë apo hibrid tanimë egzistonë Shoqata e mbarështuesve, Organizata dhe / ose Ndërmarrja private e mbarështimit, Departamenti i Prodhimtarisë Blegtorale në MBPZHR mund të vendosë të refuzojë certifikimin e shoqatave të reja të mbarështuesve Organizatave dhe /ose Ndërmarrjeve të reja mbarështuese nëse kjo rrezikon ruajtjen e racës, hibridit apo rrezikon programin zooteknik të shoqatave ekzistuese mbarështuese, të organizatave dhe ose ndërmarrjeve private mbarështuese.

Departamenti i Prodhimtarisë Blegtorale në MBPZHR mund të refuzojë certifikimin e një Shoqate të re të mbarështuesve, Organizate dhe/ose një Ndërmarrje të re mbarështuese nëse kafshët e racës në fjalë mund të përfshihen në regjistër, në një pjesë të veçantë të Librit amësorë të mbajtur nga një Organizatë ose Shoqatë tjetër e cila mbanë Librin amësorë të kafshëve të asaj race.

Neni 14

Departamenti i Prodhimtarisë Blegtorale në MBPZHR nuk mund të refuzojë certifikimin e një Shoqate të re të mbarështuesve, një Organizate dhe /ose Ndërmarrjeve private të re mbarështimi për sa i përket racave dhe aktiviteteve që aktualisht i ndërmerr Qendra për Mbarështimin e Kafshëve.

Regjistri i Shoqatave të certifikuar të mbarështuesve

Neni 15

Departamenti i Prodhimtarisë Blegtorale në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të mbajë Regjistrin e Shoqatave të mbarështuesve, Organizatave dhe/ose Ndërmarrjeve private të mbarështuesve të certifikuar.

Shoqatat e mbarështuesve, Organizatat dhe/ose Ndërmarrjet private mbarështuese të certifikuar për mbajtjen dhe/ose themelimin e Librave amësorë, Regjistrave dhe Regjistrave të hibrideve nuk mund të kërkojnë nga pronari i kopesë të jetë anëtarë si parakusht për regjistrimin e kopesë së kafshëve riprodhuese të racës së pastër ose hibrideve në Librin amësorë ose Regjistrat e hibrideve, por, jo anëtarët paguajnë taksën për regjistrimin e kopesë.

Shoqatat e mbarështuesve, Organizatat dhe/ose Ndërmarrjet private mbarështuese të certifikuar për mbajtjen ose themelimin e Librave amësorë, regjistrave ose regjistrave të hibrideve, nëse kërkohet nga pronari i kopësë do të lëshojë certifikatë mbarështimi që tregon se kafshët riprodhuese të racës së pastër ose hibridet janë të regjistruara në Librin amësorë të racës, Regjistër ose Regjistër të hibrideve.

Shoqatat e mbarështuesve, Organizatat dhe/ose Ndërmarrjet private mbarështuese të certifikuar për mbajtjen ose themelimin e Librave amësorë, Regjistrave ose Regjistrave të hibrideve kanë të drejtë të kontrollojnë kafshët riprodhuese të racës së pastër ose hibridet për të cilat pronari ka kërkuar regjistrimin në Librin amësorë, Regjistër ose certifikatë të mbarështimit.

Kafshët riprodhuese të racës së pastër dhe hibridet, sperma, ovulët dhe embrionet në rast të tregtimit dhe eksportit do të përcillen me një certifikatë mbarështimi në pajtim me dispozitat e Udhëzimeve Administrative për mbarështimin e kafshëve.

Departamenti i Prodhimtarisë Blegtorale në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me një njoftim me shkrim një muaj më herët do të tërheqë certifikimin të cilës do Shoqatë të mbarështuesve, Organizatë dhe/ose Ndërmarrje private mbarështuese që mbanë Libra amësorë, Regjistra ose Regjistra të hibrideve nëse kushtet e përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ nuk janë plotësuar në mënyrë të vazhdueshme nga Shoqata e mbarështuesve, Organizata dhe/ose Ndërmarrja private mbarështuese.

Kapitulli III

Licencimi i personave për të kryer mbarsim artificial

Neni 16

Qendra për Mbarështimin e Kafshëve organizon trajnime me përmbajtje të mjaftueshme praktike dhe teorike të teknikëve të veterinarëve dhe veterinerëve për mbarsim artificial.

Departamenti i Prodhimtarisë Blegtorale, mbarësuesve të trajnuar si në pikën 1 të këtij neni i u ndan numrin personal të licencës për mbarsim artificial.

Departamenti i Prodhimtarisë Blegtorale udhëheqë Regjistrin e mbarësuesve të licencuar për mbarsim artificial.

Vetme mbarësuesit e licencuar kanë të drejtë të kryejnë mbarsim artificial.

Mbarësuesit e licencuar janë të obliguar që periodikisht për çdo tre muaj t'i raportojnë Qendrës për Mbarështimin e Kafshëve mbi efektshmërinë e mbarësimit.

Tërheqja e licencës

Neni 17

Departamenti i Prodhimtarisë Blegtorale në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural mundet me shkrim të tërheqë licencën për mbarsim artificial me efekt të menjëhershëm në rast se :

1. Mbarësuesi i licencuar për mbarsim artificial dështon të arrijë së paku një shkallë të mbarsjes e cila është më tepër se mesatarja për vendin minus 10 %.
2. Dëshmohet që mbarësuesi i licencuar për mbarsim artificial ka mbarësuar me spermë të importuar ilegalisht
3. Sperma e përdorur për mbarsim artificial nuk është nga demi i racës së pastër riprodhues i aprovuar sipas Udhëzimit Administrativë për metodat e kontrollit të prodhimtarisë më qellim të përcaktimit të vlerës gjenetike të kafshëve riprodhuese.

Neni 18

Personave të licencuar për mbarsim artificial të cilëve iu është tërhequr licenca sipas pikës 1 të nenit 17 mund të riliçenohen pas ri trajnimit të suksesshëm në harmoni me nenin 16 pika 1 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Aprovimi i importeve të materialit riprodhues

Neni 19

Të gjitha Shoqatat e certifikuar të mbarështuesve, Organizatat dhe /ose Ndërmarrjet private mbarështuese kanë të drejtë të importojnë kafshë të gjalla, spermë, ovulë ose embrione pas marrjes së Arovimit nga Departamenti i Prodhimtarisë Blegtorale në MBPZHR, duke përdorur formularin në **Aneksin I**.

Shoqatat e certifikuar të mbarështuesve mund të importojnë kafshë të gjalla, spermë, ovulë ose embrione, vetëm për nevojat e Shoqatës.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 20

Mos zbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ sanksionohet sipas nenin 25 pika 1 (c) dhe (f) të Ligjit për Blegtorinë e Kosovës.

Neni 21

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, më 3.03.2005

Zv.ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë
dhe Zhvillim Rural
Tomë Hajdaraj

ANEKSI I

APROVIM

Për importin e materialit riprodhues, kafshë të gjalla spermë, ovula dhe embrione

NR _____

Organizata e regjistruar _____

Emri dhe Mbiemri _____

Adresa _____

Nr.tel. _____

Në harmoni me Ligjin për Blegtori dhe Udhëzimin Administrativ për certifikimin e personave dhe organizatave që ndërmarrin aktivitete të mbarështimit të kafshëve, Departamenti i Prodhimtarisë Blegtorale i MBPZHR miraton importet specifike të planifikuara me sa vijon:

Lloji i materialit riprodhues

Kafshë të gjalla për riprodhim /numri _____ /raca _____

Spermë/numri i dozave/ _____ /raca _____

Ovula dhe embrione/ numri _____ /raca _____

Vezë për qelje _____ /hibridi _____

Miratimi është dhënë me kusht që certifikatat mbarështuese për materialin riprodhues do t'i dorëzohet QMK-së më së largu 4 javë pas importimit.

Datë _____

Nënshkrimi _____